VENDIM
Nr. 186, datë 13.3.2013

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I URËS SË RE TË FSHATIT VELABISHT, NË KOMUNËN E VELABISHTIT TË QARKUT TË BERATIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i urës së re të fshatit Velabisht, në komunën e Velabishtit të qarkut të Beratit.
2. Shpronësimi bëhet në favor të komunës së Velabishtit.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në masën përkatëse sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqet 197 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë) m², truall, 500 (pesëqind) m², tokë arë, dhe 60 (gjashtëdhjetë) m², objekt, në vlerën e përgjithshme të shpronësimit 3 306 207 (tre milionë e treqind e gjashtë mijë e dyqind e shtatë) lekë.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga buxheti i Fondit Shqiptar të Zhvillimit.
5. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
6. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga komuna e Velabishtit.
7. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga komuna e Velabishtit për realizimin e këtij projekti.
8. Regjistrimi i ri i pasurive prej 197 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë) m², truall, 500 (pesëqind) m², tokë arë dhe 60 (gjashtëdhjetë) m², objekt, shpronësuar në favor të komunës së Velabishtit, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
9. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe komuna e Velabishtit për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha